

Program i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Mësuesi në Histori-Gjeografi

Emërtimi akademik i studimit	DIPLOMË
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces
Cikli i studimit	Cikli i dytë i studimeve “Master i Shkencave”
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kriteret e pranimit	a.Pranimi i studentëve në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, i cili jep akses në programet e ciklit të dytë të studimeve, në fushën e mësuesisë. b. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), në nivelin B, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. c.Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës së notës së tyre mesatare të ciklit të parë, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia Bazë, atëherë kandidatët do tëseleksionohen sipas: Nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor” për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Mësuesi në Histori-Gjeografi”, në Universitetin e Gjirokastrës.

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Të përgatisë mësues të aftë shkencërisht dhe metodistë në fushat e historisë dhe gjeografisë të cilët do të edukojnë brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të arsimit parauniversitar me njohuritë teorike dhe praktike nga fushat e sipërpërmendura. Gjithashtu edhe specialistë të historisë dhe gjeografisë për të punuar në profile pune të afërta me këto fusha.
2. Programi i ciklit të dytë të studimeve ka për qëllim të pajisë studentët me aftësi dhe cilësi intelektuale nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkak-pasojë, të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe argumentuara dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.
3. Programi lidh vlerat e të mësuarit të historisë dhe gjeografisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës, duke ndërtuar tek studentët konceptet, kompetencat qytetare, të komunikimit, të të shprehurit, të të menduarit, të të nxënit, kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, kompetencat personale, digjitale si dhe cilësitë historike dhe gjeografike, nëpërmjet:
 - a) Paisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike dhe gjeografike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike dhe gjeografike të së ardhmes.
 - b) Krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë.
 - c) Angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik dhe gjeografik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik.
 - d) Zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik dhe gjeografik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
 - e) Interpretimit të efektit të kohës dhe hapësirës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrdhëniet historike dhe fenomeneve gjeografike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes.
 - f) Interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen.
 - g) Kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike e gjeografike janë interpretuar në mënyra të ndryshme.
 - h) Zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik dhe gjeografik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike dhe gjeografike.

- i) Ndërveprimet me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike.
- j) Mundësimet të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit të trashëgimisë së tyre historike dhe gjeografike të përbashkët.
- k) Vlerësimet të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore.
- l) Argumentimet të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli.
- m) Zhvillimet të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- n) Ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike dhe gjeografike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimeve të ndryshme.
- o) Paisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës.

Objektivat formuese të programit të studimit:

Pas përfundimit të studimeve i diplomuari të jetë i aftë të përcjellë tek nxënësit njohuritë shkencore të fituara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, që lidhen me fushat e historisë dhe gjeografisë:

- a) Të zotërojnë formim të plotë për të ushtruar profesionin e mësuesit.
- b) Të integrojnë njohuritë e fituara në fushën e historisë dhe gjeografisë me ato psiko-pedagogjike.
- c) Të aftësohet në procesin e mësimdhënies për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë.
- d) Të përfitojë aftësitë psiko-pedagogjike të domosdoshme në punën me kategori të veçanta sociale, kulturore dhe psikologjike.
- e) Të aftësohet për hartimin dhe realizimin e planeve dhe programeve mësimore të arsimit parauniversitar.
- f) Të jetë në gjendje të hartojë planet edukative të klasës në përputhje me temperamentin dhe veçoritë psiko-sociale të nxënësve.
- g) Të zotërojnë aftësi menaxhuese si një menaxhues kompetent për harmonizimin e problemeve shkollë-familje-komunitet.
- h) Të jetë i aftë për të zgjidhur problematika të ndryshme që kanë të bëjnë me problemet e shkollës.
- i) Të jetë i aftë të integrojë dhe harmonizojë njohuritë në fushën e historisë dhe gjeografisë me edukimin qytetar.
- j) Të jetë i aftë të nxisë tek nxënësi të menduarit kritik e krijues.

- k) Të jetë i aftë të punojë me klasa kolektive.
- l) Të jetë i aftë të evidentojë dhe edukojë frymën e integritit, globalizimit, tolerancës etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

I. LËNDË TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM:

1. Psikologji Zhvillimi dhe Edukimi
2. Metodot e kërkimit shkencor në histori
3. Metodot e kërkimit shkencor në gjeografi

KREDITE (12 ECTS)

II. LËNDË TË FORMIMIT KARAKTERIZUES:

1. Kurrikula dhe arsimi gjithëpërfshirës
2. Metodologji e mësimdhënies dhe të nxënit
3. Vlerësimi i të nxënit
4. Didaktika e Historisë
5. Didaktika e Gjeografisë
6. Gjeografia dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm
7. Gjeopolitika rajonale bashkëkohore
8. Studime të thelluara të historisë bashkëkohore
9. Trashëgimia natyrore e kulturore në Shqipëri
10. Historia e Bashkimit Evropian
11. Gjeografia e problemeve globale
12. Njohuri për shtetin dhe qeverisjen

KREDITE (60 ECTS)

III. LËNDË INTEGRUESE:

1. Menaxhimi i klasës
2. Metodot e kërkimit në edukim
3. Shteti i mirëqënies sociale
4. Seminar në gjeografinë rajonale të Shqipërisë

KREDITE (18 ECTS)

IV. LËNDË ME ZGJEDHJE HISTORI (Viti II, semestri I):

1. Histori e trojeve dhe diasporës shqiptare
2. Histori e Perandorisë Osmane
3. Marrëdhëniet kishë-shtet në Evropë
4. Politikat e të drejtave të njeriut

KREDITE (3 ECTS)

V. LËNDË ME ZGJEDHJE GJEOGRAFI (Viti II, semestri II):

1. Të mësuarit e koncepteve kryesore të gjeografisë fizike
2. Të mësuarit e koncepteve kryesore të gjeografisë humane
3. Të mësuarit e koncepteve kryesore të gjeografisë rajonale
4. Të mësuarit e koncepteve kryesore mjedisore në gjeografi.

KREDITE (3 ECTS)

VI. LËNDË TË FORMIMIT PLOTËSUES:

1. Praktikë Profesionale

KREDITE (12 ECTS)

VII. PËRGATITJE PROVIM FORMIMI / PUNIM DIPLOME:

KREDITE (12 ECTS)

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 -54 pikë
6 (gjashtë)	55 -64pikë
7 (shtatë)	65 -74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Diploma Master i Shkencave në mësuesi në Histori-Gjeografi është ura lidhëse e studentit me tregun e punës në fushën e mësuesisë. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të formojë dhe ti afrooj sa më shumë studentë me tregun e punës.

Pasi të kenë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në mësuesi në Histori-Gjeografi, studentët kanë mundësi të punësohen si:

1. Mësues të historisë dhe gjeografisë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.
2. Specialistë në administratën publike (arkivistë, punonjës në sektorin e trashëgimisë së të mirave materiale e kulturore, specialist të mjedisit apo të turizmit etj).
3. Specialistë në sektorët e administrimit, konservimit dhe restaurimit të pasurive arkeologjike, artistike, dokumentare dhe monumentale.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I PARË				
1.	Psikologji Zhvillimi dhe Edukimi	6	150	I
2.	Metodat e kërkimit shkencor në histori	3	75	I
3.	Metodat e kërkimit shkencor në gjeografi	3	75	I
4.	Kurrikula dhe arsimi gjithëpërfshirës	5	125	II
5.	Metodologjia e mësimdhënies dhe të nxënit	7	175	II
6.	Vlerësimi i të nxënit	6	150	II
7.	Didaktika e Historisë	6	150	II
8.	Didaktika e Gjeografisë	6	150	I
9.	Gjeografia dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	5	125	I
10.	Gjeopolitika rajonale bashkëkohore	4	100	II
11.	Studime të thelluara të historisë bashkëkohore	3	75	II
12.	Menaxhimi i klasës	3	75	II
13.	Metodat e kërkimit në edukim	3	75	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I DYTË				
1.	Trashëgimia natyrore e kulturore në Shqipëri	6	150	I
2.	Historia e Bashkimit Evropian	3	75	I
3.	Gjeografia e problemeve globale	3	75	II
4.	Njohuri për shtetin dhe qeverisjen	6	150	I
5.	Lëndë me zgjedhje histori:			
	Histori e trojeve dhe diasporës shqiptare	3	75	I
	Histori e Perandorisë Osmane			
	Marrëdhëniet kishë-shtet në Evropë			
	Politikat e të drejtave të njeriut			
6.	Lëndë me zgjedhje gjeografi:			
	Të mësuarit e koncepteve kryesore të gjeografisë fizike	3	75	II
	Të mësuarit e koncepteve kryesore të gjeografisë humane			
	Të mësuarit e koncepteve kryesore të gjeografisë rajonale			
	Të mësuarit e koncepteve kryesore mjedisore në gjeografi			
7.	Shteti i mirëqënies sociale	6	150	I
8.	Seminar në Gjeografinë rajonale të Shqipërisë	6	150	I
9.	Praktikë Profesionale	12	300	I/II
14.	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	12		
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	
Gjithësej viti i parë + viti i dytë		120	3000	

